REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 100/22
Datë/Datum. 08.08.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Psh.nr.100/22

Bordi i Organit Shqyrtues i Prokurimit Publik, në bazë të nenit 5, nenit 105, nenit 106 si dhe nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, si dhe 104 të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 05/L -031, në përbërje znj. Vjosa Gradinaj Mexhuani- Kryetare, z. Vedat Poterqoi - Anëtar, z. Agon Ramadani- Anëtar, znj. Kimete Gashi- Anëtare dhe znj. Nita Bejta Cerkini- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës me **nr. 100/22**, të parashtruar nga operatori ekonomik, **OE D.P.H "Luzern" -Prishtinë,** Bordi i OSHP-së me datën: 12 korrik 2022, mori këtë:

V E N D I M

- **Hudhet si jashtë afatit për shqyrtim,** ankesa e operatorit ekonomik **OE D.P.H "Luzern" -Prishtinë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbime Hoteliere-Bufe e ish bankosit-Ritender", me nr.prokurimit:214-22-526-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- **Ministria e Punëve të Brendshme.**

- Konform nenit 118 të LPP-së iu kthehet sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

- Obligohen operatoret ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: **OE D.P.H "Luzern" -Prishtinë,**si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me nr. 100/22, me datën 14.04.2022, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Shërbime Hoteliere-Bufe e ish bankosit-Ritender", me nr.prokurimit:214-22-526-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- **Ministria e Punëve të Brendshme.**

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se nga data 01. 04. 2021 ka funksionuar pa Bordin për shkak se atij paraprak i ka kaluar mandati ligjor për shqyrtim sipas kompetencave të parapara me ligj, dhe rrjedhimisht nuk ka qenë e mundur që të krijohen panelet shqyrtuese për marrjen e një vendimi përfundimtar ashtu siç është e paraparë me nenin 117 të LPP-së lidhur me nenin 5 të po këtij ligji, si dhe nenit 104 të Ligjit për Procedurë Administrative.

Anëtarët e Bordit të OSHP-së pas analize të të gjithë situatës në tërësi dhe diskutimeve të shumta, përparësive për shqyrtim dhe mos shqyrtim të ankesave që janë pranuar gjatë kohës sa Bordi ka qenë jo funksional, në mbledhjen e mbajtur me datën 12 korrik 2022, me shumicë votash konstatuan se ankesat e parashtruara nuk mund të shqyrtohen për faktin se kanë kaluar afatet ligjore për shqyrtim dhe të njëjtat janë jashtë afatit për shqyrtim.

Bordi i OSHP-së duke u bazuar në nenin 104 të Ligjit për Procedurën Administrative ku thuhet: "*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti*

për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë", vlerëson se pas kalimit të të gjitha afateve ligjore për shqyrtim ashtu siç parashihet në LPP në nenet 114 115 dhe 117 që përcakton afatet e mundshme deri të marrja e vendimit përfundimtar sa i përket shqyrtimit të një ankese, qëllimi i shqyrtimit të ankesave të grumbulluara është bërë i pamundur dhe i kotë.

Në bazë të këtyre dispozitave ligjore afati i përgjithshëm deri te nxjerrja e një vendimi përfundimtar është 34 ditë si dhe OSHP mund të përcaktojë çështjen si çështje shumë të ndërlikuar dhe të shtyjë afatin për jo më shumë se njëzet (20) ditë për nxjerrjen vendimit të tij, deklaratës mbi arsyet dhe urdhrit të tij. Andaj, Bordi i OSHP-së, duke u bazuar në të gjitha këto dispozita ligjore, kalimin e afateve ligjore dhe pamundësisë për të nxjerr një vendim përfundimtar nga paneli shqyrtues i OSHP-së, gjithmonë duke pasur parasysh interesin publik, vlerëson se shqyrtimi i këtyre ankesave, do të ishte në kundërshtim me ligjin.

Marrë parasysh mos ekzistencën e organit te shkallës së dytë, në këtë rast të Bordit të OSHP-së, sipas nenit 124, paragrafi 6.1 të LPPA-së, bordi ka konsideruar se palët kanë pas mundësinë e shfrytëzimit të mjetit juridik, të padisë, për realizimin e pretendimeve të tyre si dhe marrjen e një vendimi meritor nga Gjykata. Për më tepër, të njëjtat kanë pasur mundësinë të ushtrojnë bashkë me padi edhe kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit sipas nenit 22 të LKA-së pranë Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative.

Meqë ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, rrjedhimisht kemi edhe kontrata te nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, pastaj disa autoritete kontraktuese këto aktivitete te prokurimit të cilat janë objekt i ankesës nuk i kanë në planin buxhetor të këtij viti andaj është e pamundur të bëhet edhe zotimi i mjeteve që është kusht për nënshkrim të kontratave publike.

Bordi si rrethanë tjetër ne marrjen e këtij vendimi ka marrë parasysh edhe ngritjen e konsiderueshëm të çmimeve, fakt ky që është i njohur botërisht, andaj konsiderojmë se mund të mos ketë interes nga operatorët ekonomik të nënshkruhen kontratat që janë objekt i ankesës.

Bordi i OSHP-së konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryetarja e OSHP-së

Znj. Vjosa Gradinaj Mexhuani

Anëtarët:

Z. Vedat Poterqoi

Z. Agon Ramadani

Znj. Kimete Gashi

Znj. Nita Bejta Çerkini

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 **AK – Ministria e Punëve të Brendshme**

1x1 **OE- D.P.H "Luzern" -Prishtinë**

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.